



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1501 prot.

Tiranë, më 27/10/2021

V E N D I M

Nr. 209, datë 27.10. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 151 regj, datë 05.08.2021, paraqitur nga ankuesi K.R kundër Bashkisë Berat, ku pretendohet diskriminim për shkak të *bindjeve politike*. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri),

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi K.R, shpjegon se, ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Berat. Ankuesi ka filluar punë në datën 07.09.2018, me detyrën “*Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë Berat*” dhe marrëdhëniet e punës kanë qenë me afat të pacaktuar. Me urdhrin nr.565, datë 02.08.2019, Kryetari i Bashkisë Berat ka urdhëruar: “*1. Z.K.R, Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë, Bashkia Berat, shkarkohet nga detyra dhe i zgjidhet kontrata individuale e punës. 2. Paga për lejen vjetore të pakryer në masën 12 ditë. 3. Marrëdhëniet financiare të punës do të përfundojnë në datën 06.08.2019*”. Ankuesi shprehet se, në urdhrin e mësipërm, nuk është vendosur asnjë shkak dhe asnjë motivacion për largimin e tij nga detyra dhe nuk është njoftuar për takim përpara se të njoftohej për zgjidhjen e kontratës së punës.

Ankuesi deklaron se, gjatë kohës që ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Berat, por edhe përpara saj, ka qenë anëtar i Partisë levizja Socialiste për Integrim (LSI). Si person i kësaj force politike, ankuesi shprehet se ka kandiduar për zgjedhjet vendore të vitit 2011-2014, ku është zgjedhur

Kryetar i Komunës Velabisht, Berat. Ky fakt sipas ankuesit ka qenë i njohur për Kryetarin e ri të Bashkisë Berat, i cili filloi detyrën në muajin gusht 2019.

Ankuesi deklaroi se, gjatë 11 muajve që ka punuar pranë Bashkisë Berat, nuk ka marrë asnjëherë masë disiplinore nga punëdhënësi dhe se ka punuar me korrektësi dhe disiplinë. Ankuesi pretendon se urdhri i largimit të tij nga puna është i kundraligjshëm dhe i pabazuar në ligj apo në dokumentacionin shkresor dhe se largimi i tij ka patur si arsye bindjet e tij politike.

Ankuesi deklaroi se, me fillimin e detyrës, Kryetari i Bashkisë Berat, i zgjedhur nga forca politike Partia Socialiste, u njoh me gadishmërinë e tij për të vijuar detyrën sipas ligjit, por nuk respektoi asnjë dispozitë të ligjit apo të Rregullores së Bashkisë Berat. Në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Berat *“Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së administratës së Bashkisë”*, saktësohet roli i këshilltarëve të kabinetit, ku në nenin 17, parashikohet: *“Kabineti mbështet drejtëpërdrejtë Kryetarin.....Kabineti i Kryetarit të Bashkisë shërben drejtëpërdrejtë si organ këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë dhe ndjek problemet e përditshme të punës në institucion duke krijuar kushtet e nevojshme për angazhimin e Kryetarit në çështjet kryesore të drejtimit....”* Sipas ankuesit detyra e Këshilltarit të Kabinetit është një detyrë e normuar nga ligji dhe rregullorja përkatëse dhe nuk mund të konsiderohet si një detyrë e panormuar dhe e pakontrolluar. Ai shpreh se, Kryetari i Bashkisë, pa i lënë asnjë ditë kohë për të shfaqur aftësitë e tij në ushtrimin e detyrës, ka nxjerrë urdhrin për zgjidhjen e kontratës së punës. Ankuesi pretendon se, janë pikërisht bindjet e tij politike shkak i vetëm për të cilin është zgjidhur kontrata e tij e punës.

Ankuesi deklaroi se, veprimet diskriminuese ndaj tij kanë qenë në vijimësi prej punonjësve të administratës së pushtetit vendor, të vendosur në këto detyra nga forca politike Partia Socialiste. Kështu në vitin 2015, pas mbarimit të mandatit të Kryetarit të Komunës Velabisht, Berat, i vendosur nga LSI, në vitin 2015 ka filluar punë si nënkryetar i Këshillit të Qarkut Berat, deri në muajin shkurt të vitit 2018. Në muajin shkurt të 2018 me anë të votimit të anëtarëve të Këshillit të Qarkut Berat, të vendosur nga forca politike Partia Socialiste, ankuesi shpreh se është shkarkuar pa asnjë motivacion, por motivi i vërtetë sipas tij ishte fakti se kishte qenë ish-Kryetar i Komunës Velabisht, Berat i vendosur nga LSI.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga Bashkia Berat për shkak të bindjeve politike dhe marrjen e masave nga ana e Bashkisë Berat për rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1168/1 prot., datë 11.08.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Berat, në lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesi. Me shkresën nr.4163/1 prot., datë 22.08.2021¹, Bashkia Berat ka kthyer përgjigje duke parashtruar sa vijon:

Ankuesi K.R ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Berat me detyrë Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë. Këtë detyrë e ka mbajtur nga data 07.09.2018 deri më 06.08.2019, datë në të cilën i kanë përfunduar marrëdhëniet juridike dhe financiare të punës.

Së pari, ankuesi ka paraqitur ankesën e tij pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me datë 05.08.2021, në të cilën pretendon se largimi nga puna ka qenë për shkaqe politike (siç citohet në shkresën nr.1168/1 prot datë 11.08.2021). Në lidhje me pretendimet e subjektit ankues, bashkia sqaron se me Urdhrin nr.565, datë 02.08.2019, e Kryetarit të Bashkisë Berat, ankuesi është larguar nga puna për arsye të mosrealizimit të objektivave të Bashkisë Berat. Referuar ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 64, citohet: “*emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, punonjësit e tjerë të strukturave të bashkisë dhe i shkarkon ata*”.

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1168/3 prot., datë 30.08.2021.

Bashkia hedh poshtë pretendimet e ankuesit si të pavërteta dhe të pabazuar në fakte e prova. Bashkia shpjegon se, misioni i organeve të qeverisjes vendore është që të sigurojë qeverisjen e efektshme dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Në shtatë mujorin e fundit të vitit 2019, në Bashkinë Berat është konstatuar një gjendje ekonomike financiare shumë e rëndë, me një bilanc negativ të aftësisë së saj paguese. Ky fakt ka sjellë si rezultat, rishikimin e marrëdhënieve të punës me z. K.R, në pozicionin e Këshilltarit në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë. Ankuesi, si dhe i gjithë stafi i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, pasi funksioni i këtij organi është i lidhur ngushtë me pozicionin e Kryetarit të Bashkisë dhe funksioneve që ai përmbush gjatë mandatit të vetë. Duke qenë i këtij karakteri, Kryetarit të Bashkisë i lind e drejta që të për zgjedh vetë anëtarët e këtij organi për vijim sa më të mirë të përmbushjes së funksioneve të tij.

Bashkia thekson se, marrëdhëniet e punës mes Kryetarit të Bashkisë, që është një person politik i zgjedhur pas një procesi zgjedhor dhe kabinetit të tij, nuk janë thjesht marrëdhënie punësimi si me punonjësit e tjerë të administratës publike, që gëzojnë një mbrojtje të gjerë nga Kodi i Punës dhe ligji nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi duhet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë besimi nga ana e Kryetarit, për të deleguar zgjidhjen e detyrave të ndryshme administrative dhe politike, një funksionari që gëzon besimin e tij. Bashkia shprehet se veprimet e saj janë të ligjshme dhe në respektim të praktikës ligjore që ka ndjekur dhe është mbështetur Bashkia Berat.

Bashkia Berat shprehet se, gjithmonë ka siguruar të drejtën e punonjësve për barazi përpara ligjit dhe trajtim të barabartë për çdo punonjës. Në asnjë rast nuk është ushtruar presion ose veprim diskriminues, por çdo veprim është kryer në kuadër të punës dhe mirëfunksionimit të detyrave dhe përgjegjësisë të bashkisë. Në Bashkinë Berat aktualisht ka punonjës të cilët janë me bindje politike të ndryshme dhe në asnjë moment nuk janë diskriminuar nga Kryetari i Bashkisë ose punonjës të tjerë të saj. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë anëtarë të të njëjtës forcë politike që pretendon se aderon ankuesi dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Bashkia shprehet se, në dosjen personale të ankuesit, e cila ndodhet në drejtorinë përkatëse, nuk ka snjë dokument që të vërtetojë se ankuesi aderon në ndonjë forcë politike. Gjithashtu, ankuesi në asnjë rast nuk jep fakte dhe prova të cilat vërtetojnë se është diskriminuar nga punëdhënësi. Nga ana tjetër bashkia shprehet se, nuk ka patur asnjë informacion për bindjen politike të ankuesit dhe aq më pak për kartën e anëtarësisë, të cilën ai e përmend në ankim. Ky informacion u vu në dijeni të Bashkisë Berat me anë të ankimit të z. K.R.

Bashkia thekson se, Komisioneri ka shqyrtuar edhe ankesat e z. B.B dhe z. Ç.B, të cilët kanë qenë Zv.Kryetarë të Bashkisë Berat në të njëjtën periudhë me ankuesin dhe se procedura e

largimit nga puna dhe motivacioni, ka qenë i njëjtë me ankuesin K.R. Bashkia shprehet se, Komisioneri në përfundim të shqyrtimit të ankesave të shtetasve B.B dhe Ç.B, vendosi konstatimin e mosdiskriminimit të tyre për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Berat.

Ndër të tjera, Bashkia Berat, ka informuar Komisionerin se ankuesi i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat lidhur me mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe afateve të njoftimit, e cila ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë e tij. Në vijim, nga Bashkia Berat është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe çështja është aktualisht në gjykim.

2. Me shkresën nr.1168/4 prot., datë 18.10.2021, ankuesi ka kthyer përgjigje në lidhje me parashtrimet e Bashkisë Berat.
3. Me *e-mail* datë 21.10.2021, ankuesi ka dërguar kopje të akteve të largimit nga detyra si Zv/kryetar i Këshillit të Qarkut Berat, në vitin 2018.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se, ankuesi K.R, ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Berat në pozicionin e punës “*Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë*”. Ankuesi është emëruar në këtë pozicion pune me urdhrin nr.706, datë 06.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Berat. Ankuesi ka qëndruar në këtë detyrë deri në datën 06.08.2019, kur është shkarkuar nga detyra me urdhrin nr.565, datë 02.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat.

Referuar urdhrin për shkarkimin nga detyra me nr.565, datë 02.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, ankuesit nuk i është bërë me dije asnjë motivacion për shkarkimin e tij nga detyra. Sipas urdhrin nr.565, datë 02.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, konstatohet se, largimi i ankuesit nga detyra është bërë duke i`u referuar nenit 153, të Kodit të Punës. Pra, sipas pretendimit të Bashkisë Berat, largimi i ankuesit nga detyra është bërë për shkaqe të justifikuara që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vijimin e marrëdhënieve të punës.

Gjithashtu, sipas pretendimeve të Bashkisë Berat, ankuesi K.R është larguar nga puna për shkak të gjendjes ekonomike financiare shumë të rëndë dhe një bilanci negativ të aftësisë së saj paguese të konstatuar në shtatë mujorin e fundit të vitit 2019 në Bashkinë Berat. Për të vërtetuar këtë fakt Bashkia Berat, nuk ka dorëzuar asnjë dokument që do të shërbente si provë. Gjithashtu, Bashkia Berat, pretendon se, marrëdhënia e punës midis Kryetarit të Bashkisë, i cili është një

person politik i zgjedhur pas një procesi zgjedhor dhe anëtarëve të Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, nuk janë marrëdhënie punësi si me punonjësit e tjerë të administratës publike që gëzojnë mbrojtje të gjerë nga Kodi i Punës dhe ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi duhet të ekzistojë një marrëdhënie besimi nga ana e Kryetarit, për të deleguar zgjidhjen e detyrave të ndryshme, duke qenë se këto funksione parashikohen në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Ankuesi ka ngritur pretendimin se, shkarkimi nga detyra si Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë, ka ardhur për arsye se, është anëtar i subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI). Me shkresën nr. 1168/4 prot., datë 18.10.2021, ankuesi vendosi në dispozicion vërtetimin datë 04.10.2021, lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, Dega Berat, sipas të cilit rezulton se, ankuesi është anëtar i kësaj force politike që prej themelimit të saj, aktualisht është anëtar i Kryesisë pranë LSI Bashkia Berat, si dhe ka drejtuar në cilësinë e Kryetarit të ish Komunës Velabisht Berat, i propozuar nga subjekti politik LSI.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ)², rezulton se, në Zgjedhjet Vendore të vitit 2011, ankuesi është zgjedhur Kryetar i Komunës Velabisht, Rrethi Berat, i propozuar dhe mbështetur nga Koalicioni “Aleanca për Qytetarin”, në përbërje të të cilit ka qenë subjekti politik LSI.

Sipas të dhënave të KQZ-së, gjatë periudhës së vitit 2015-2019, Bashkia Berat është drejtuar nga kandidati i zgjedhur nga subjekti politik, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) në kuadër të koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”. Referuar të dhënave të KQZ-së në zgjedhjet vendore të vitit 2019, Bashkia Berat drejtohet nga kandidati i zgjedhur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), në kuadër të koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, ndërsa subjekti politik LSI, nuk mori pjesë në zgjedhjet vendore.

Nga aktet e administruara rezulton se, me vendimin nr. 1, datë 12.01.2018, të Këshillit të Qarkut Berat, ankuesi është liruar nga detyra e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Qarkut Berat. Kjo vendimarrje rezulton të jetë marrë pas paraqitjes së kërkesës nga ana e disa anëtarëve të Këshillit të Qarkut, për ndryshime në drejtuesit e Këshillit të Qarkut, si pasojë e ndryshimeve të raporteve politike, duke kërkuar për këtë arsye, zëvendësimin e z.K.R. në detyrën e Zv/kryetarit dhe përfaqësues i LSI, me një anëtar tjetër të Këshillit, i cili të përfaqësojë forcën politike e cila ishte në maxhorancë dhe drejton qeverisjen e vendit dhe Këshillin e Qarkut.

²Shiko: http://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Legjislacioni_2011/Vendime_2011/VENDIM%201229/Lidhja%201.pdf

Shiko: http://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2011/subjektet%20zgjedhore/Regjistri%20i%20partive_05.03.pdf

Për faktet e cituara më sipër, që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se: *“Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim”*, nuk lind nevoja për verifikim.

Në analizë të fakteve dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi si dhe referuar legjislacionit të zbatueshëm në çështjen objekt shqyrtimi, Komisioneri konstaton se:

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu procesin disiplinor dhe pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Sikurse rezulton nga akti i emërimit dhe shkarkimit nga detyra të ankuesit rezulton se, marrëdhëniet e punës janë rregulluar nga ligji nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar dhe Kodi i Punës. Referuar këtij të parit, nuk ka rregullime të posaçme në lidhje me mënyrën e emërimit ose të shkarkimit të Këshilltarit të Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.

Bashkia Berat, pretendon se natyra e marrëdhënies së punës që krijohet midis Kryetarit të Bashkisë dhe Këshilltarit në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë, nuk është një marrëdhënie punësimi si me punonjësit e tjerë, përfshi këtu ata me Kod Punë ose nëpunësit civil.

Ligji nr.139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, (në vijim ligji nr.139/2015) nuk rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë funksionin e Këshilltarit në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë. Referuar nenit 64, këtij ligji, Kryetari i Bashkisë ka kompetencën e drejtëpërdrejtë për emërimin ose shkarkimin e disa funksioneve të caktuara si, zëvendëskryetarit/zëvendëskryetarëve (germa “e”), administratorët e njësive administrative /lagjeve (germa “ë”), anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi (germa “f”) apo nëpunësit vendorë për barazinë gjinore (germa “k”). Ndërsa në germen “g”, të nenit të sipërcituar, Kryetari i Bashkisë, emëron dhe shkarkon, punonjësit e strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil (germa “g”).

Organet e vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore. Megjithatë në veprimtarinë e tyre organet e njëjshme të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore. (neni 4, i ligjit nr.139/2015) Bazuar në autonominë e tyre, organet e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë vetë strukturën organizative dhe numrin e punonjësve për kryerjen e funksioneve që atyre, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.

Në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së administratës së bashkisë”, miratuar dhe regjistruar nr.737 prot , datë 07.02.2018³ , në nenin 17, rregullohet natyra, përbërja dhe kompetencat e Kabinetit të Kryetarit. Në këtë nen, ndër të tjera, përcaktohet se : *“Kabineti mbështet drejtëpërdrejt Kryetarin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti i Kryetarit të Bashkisë shërben si organ këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë dhe ndjek problemet e përditshme të punës në institucion duke krijuar kushtet e nevojshme për angazhimin e Kryetarit në çështjet kryesore të drejtimit. Ndjek dhe drejton përgatitjen dhe përpunimin e njoftimeve dhe materialeve të tjera që i parashtrohen Kryetarit. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të Bashkisë. Funksionarët e Kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin e bashkisë, përveçse në rastet kur autorizohen nga Kryetari.....”* Në këtë nen, në vijim përcaktohen detyrat e Drejtorit të Kabinetit dhe Këshilltarit të Kabinetit.

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.893, datë 17.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”,* (në vijim VKM nr.893, datë 17.12.2014) në pikat 5, 6 dhe 7, përcaktohet se: *“5. Strukturat organizative për kryerjen e funksioneve administrative në institucionet e administratës shtetërore veçojnë në përmbajtjen e tyre tri nivele: - Funksionarë politikë; - Nëpunës civilë; - Punonjës administrativë. 6. Funksionarët politikë në ministritë e linjës organizohen brenda kabinetit të ministrit. 7. Kabineti drejtohet nga drejtori i kabinetit, i cili përgjigjet para ministrit dhe nuk është pjesë e hierarkisë administrative. Kabineti përbëhet nga: a) këshilltarët, që emërohen nga ministri. Numri i këshilltarëve, përfshirë drejtorin e kabinetit, nuk mund të jetë më shumë se 9 (nëntë) veta; b) sekretaria që ka për detyrë të ndihmojë veprimtarinë e zyrës së ministrit dhe ndërveprimin ndërmjet ministrit e punonjësve të ministrisë. Numri i punonjësve të sekretarisë nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) veta.”*

Bashkia Berat, si një njësi e vetëqeverisjes vendore, nuk është pjesë e institucioneve të administratës shtetërore dhe për rrjedhojë VKM-ja e mësipërme nuk është e detyrueshme për t'u

³ Sipas publikimit në faqen zyrtare të Bashkisë Berat : <http://bashkiaberat.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/RREGULLORE-VITI-2018.pdf>

zbatuar. Në pikën 2, të VKM-së së mësipërme, rekomandohen drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura dhe të sistemit gjyqësor e të prokurorisë të zbatojnë të njëjtat standarde gjatë hartimit të strukturave organizative për administratat e institucioneve të tyre.

Referuar organizimit dhe funksionimit të administratës së Bashkisë Berat, të parashikuar në Rregulloren e Brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së administratës së bashkisë”*, konstatohet se, në përbërje të strukturave organizative për kryerjen e funksioneve në këtë njësi të vetëqeverisjes vendore, siç është Bashkia Berat, veçohet edhe struktura e Kabinetit të Kryetarit. Sikurse përcaktohet në nenin 17, të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Berat, struktura e Kabinetit të Kryetarit ka natyrë këshillimore dhe është një strukturë që shërben ekskluzivisht për të mbështetur Kryetarin e Bashkisë në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij dhe nuk ushtron kompetenca të vetat si strukturë.

Komisioneri vlerëson se, përcaktimet e bëra në VKM-në nr.893, datë 17.12.2014, edhe pse i drejtohen institucioneve të administratës shtetërore, për sa i përket kuptimit dhe natyrës së strukturave administrative për kryerjen e funksioneve administrative në institucionet e administratës shtetërore, ato gjejnë zbatim edhe për strukturat administrative për kryerjen e funksioneve administrative në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për sa kohë nuk ka parashikime të tjera ose të ndryshme në ligjin nr.139/2015. Në këtë kontekst, referuar VKM-së nr.893, datë 17.04.2014, rezulton se brenda strukturave organizative të Kabineteve, të drejtuesve të institucioneve të administratës shtetërore, bëjnë pjesë ata që quhen funksionarë politikë. Për analogji, edhe personat që janë pjesë e Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, janë funksionarë politikë. Pra, marrëdhëniet midis Kryetarit të Bashkisë dhe anëtarëve të Kabinetit të tij, në rastin konkret me ankuesin në detyrën e Këshilltarit në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë, nuk janë thjesht marrëdhënie administrative hierarkike, por edhe të natyrës politike.

Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret, ndodhemi para një situatë të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për shkak se ankuesi është anëtar i një subjekti politik të kundërt me atë që drejton institucionin. Në këto raste, raporti i besimit që karakterizon marrëdhënien midis Kryetarit të Bashkisë dhe Këshilltarit në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë, justifikon zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, pasi lidhet ngushtësisht me funksionin e ankuesit si Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë dhe raporteve konfidenciale, bashkëpunuese dhe të mirëbesimit, si dhe marrëdhënieve të ngushta që duhet të kenë personat që mbulojnë postet e Kryetarit dhe Këshilltarit në Kabinetin Kryetarit. Në këto kushte, largimi i ankuesit nga detyra nuk mund të konsiderohet se është bërë për shkaqe diskriminuese, por ai rezulton i përligjur objektivisht.

Të njëjtin qëndrim, Komisioneri ka mbajtur edhe për pozicionin e zëvendëskryetarit të bashkisë, duke i konsideruar këto pozicione politike, që legjitimojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës⁴.

Gjithsesi, nga sa më sipër argumentuar, mos cenimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit nga ana e punëdhënësit, nuk do të thotë që ky i fundit është i legjitimuar në mosrespektimin e dispozitave të Kodit të Punës që shkojnë në mbrojtje të çdo punonjësi.

Nga aktet e administruara rezulton se, zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin është bërë në shkelje të procedurës së parashikuar nga neni 144 të Kodit të Punës, pasi ankuesi nuk është njoftuar paraprakisht për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, arsyet e zgjidhjes, dhe se Bashkia Berat në cilësinë e punëdhënësit, nuk ka zhvilluar një takim për të diskutuar me ankuesin në cilësinë e punëmarrësit lidhur vazhdimësinë e marrëdhënies së punës. Në zbatim të nenit 144/5 të Kodit të Punës, Bashkia Berat, e cila ka detyrimin për të provuar respektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, dështoi që ta bënte një gjë të tillë. Sipas nenit 153, të Kodit të Punës, punëdhënësi ka të drejtë që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës, por vetëm në kushtet e ekzistencës së shkaqeve të justifikuara. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë dispozitë, konsiderohen shkaqe të justifikuara, rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit. Bashkia Berat, e cila ka barrën e provës që të provojë ekzistencën e shkaqeve të justifikuara, që do ta legjitimonimin atë për të bërë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës me ankuesin, dështoi që ta bëjë një gjë të tillë.

Kodi i Punës synon të mbrojë punëmarrësit në përfundim të marrëdhënies së punës, duke i'u lënë atyre një kohë të përshtatshme, në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punësimit, për të gjetur një punë të re. Duke qënë se zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës me ankuesin nuk legjitimohet për shkaqe të justifikuara, ankuesit i është cënuar kjo e drejtë, pasi Bashkia Berat nuk ka respektuar aftin e njoftimit, por ka zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme.

Sa më sipër rezulton se, zgjidhja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim me garancitë e parashikuara nga Kodi i Punës, si legjislacioni i zbatueshëm në ratin konkret, për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve.

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga të dy palët rezulton se, pretendimet e ankuesit për mosrespektimin e procedurës dhe afateve të njoftimit nga ana e Bashkisë Berat, janë shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila me vendimin nr.85, datë 11.02.2020, ka konstatuar se zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës me ankuesin është

⁴ Vendimi nr.66, datë 10.06.2019 K.M kundër Bashkisë Tiranë; Vendimi nr.167, datë 18.11.2019 B.B kundër Bashkisë Berat; Vendimi nr. 128, datë 12.07.2021 Ç.B kundër Bashkisë Berat.

bërë pa shkaqe të justifikuara dhe se nuk janë respektuar procedurat dhe afatet e zgjidhjes së kontratës së punës. (*palët nuk vendosën në dispozicion kopje të vendimit të gjykatës*).

Komisioneri vlerëson se, mosrespektimi i garancive të parashikuara nga Kodi i Punës në lidhje me procedurën dhe afatet e e njoftimit, në rastin objekt shqyrtimi, nuk janë të lidhura me respektimin dhe zbatimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Berat.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e bindjes politike, të pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3, 7, pika 1, 32, pika 1, germa “a” dhe 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit K.R nga ana e Bashkisë Berat për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku : Bindja politike
Fusha : Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim